

Nr. Prot. 061/B/17

VENDIMI Nr. 1061

Për

Vazhdimin e procesit të analizës së tregjeve

“Qasja me shumicë bashkëshfrytëzimi -LLU (duke përfshirë qasjen e ndarë) në laqet metalike dhe nën-laqet me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe qasje me shumicë brezgjërë (broadband)”

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 5), nenit 31, paragrafi 8) dhe nenit 79 paragrafi 1) dhe 2) të Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109 (tutje referuar si; Ligji), Rregullores Nr.27 për Analizat e Tregut, (Ref. Nr. Prot. 039/B/14), neni 3, paragrafi 9) (tutje referuar si; Rregullorja për Analizat e Tregut), dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të (Ref. Nr.Prot.054/B/17) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (tutje referuar si; ARKEP ose Autoriteti), Bordi Drejtues i Autoritetit në përbërje prej:

- 1) z. Kreshnik Gashi Kryetar
- 2) z. Nijazi Ademaj Anëtar
- 3) z. Hazir Hajdari Anëtar
- 4) z. Bahri Anadolli Anëtar, dhe
- 5) z. Shqiprim Pula Anëtar

në mbledhjen e 22-të me radhë të mbajtur me dt. 18 Tetor 2017, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE) dhe Departamenti Ligjor (DL), unanimisht morri këtë:

VENDIM

- I. Vazhdohet procesi i analizës së tregjeve “Qasja me shumicë bashkëshfrytëzimi - LLU (duke përfshirë qasjen e ndarë) në laqet metalike dhe nën - laqet me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe qasje me shumicë brezgjërë (broadband)” i caktuar me Vendimin nr. 950 (Ref. Nr.Prot.017/B/17) dhe Vendimin nr.1033 (Ref. Nr.Prot.050/B/17).
- II. Procesi i analizës së tregjeve i përcaktuar me Vendimin e specifikuar në paragrafin I) vazhdohet **nga data 16 Tetor 2017 deri më 15 Janar 2018.**
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Neni 31, paragrafi 8) i Ligjit përcakton se: Periudha për procedurën e analizës së tregut mund të vazhdohet me një vendim të arsyetuar të Autoritetit, por jo më shumë se tre (3) herë dhe jo më shumë se tre (3) muaj për çdo herë.”

Me Vendimit Nr.950 Bordit të ARKEP të datës 15 Mars 2017 (*Ref. Nr.Prot. 017/B/17*) është iniciuar fillimi i procesit të Analizës së tregjeve:

- Qasja me shumicë bashk-shfrytëzim - LLU (duke përfshirë qasjen e ndarë) në laqet metalike dhe nën-laqet me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike
- Qasje me shumicë brezgjërë (broadband).

Objektivi i kësaj analize të tregut është vlerësimi nëse ekziston konkurrence efikase në tregjet përkatëse dhe nëse konkurrenca nuk është efektive – të përcaktoj ndërmarrësit që posedojnë fuqi të ndjeshme në treg (OFNT).

Qëllimi kryesor i kësaj analize është sigurimi i konkurrencës së mirëfilltë në tregjet përkatëse dhe të parandaloj abuzimin e fuqisë në treg nga ndërmarrjet/Operatorët me FTN.

Konform procedurave të parapara me Rregulloren për Analizat e Tregut, ARKEP ka përgatitur një pyetësor të detajuar, përmes së cilit ka kërkuar nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike që në periudhën prej 1 muaji, respektivisht deri më datë 23/04/2017 të ofrojnë informacione të nevojshme për procesin e Analizës së tregut.

Marrë parasysh faktin se në pyetësor janë kërkuar të dhëna të shumta, kemi pranuar kërkesë nga operatorët për shtyrje të afatit për plotësimin pyetësorit.

ARKEP fillimisht ka shtyrë afatin deri me datë 15/05/2017, megjithatë pas kërkesave shtesë afati është shtyrë deri më datë 01/06/2017.

Me vendimin nr.1033 (*Ref. Nr.Prot.050/B/17*) të datës 07/07/2017, ARKEP ka shtyr procesin e analizës së tregjeve të referuar më lartë, për 3 muaj , respektivisht deri më datë 15 Tetor 2017.

Andaj marr parasysh se procesi i Analizës së tregjeve të referuar më lartë në njërin anë është mjaft kompleks në vetvete si dhe tregjet të cilat janë objekt i kësaj analize gjithashtu janë më të komplikuar për t'u analizuar, vështërsitë e paraqitura në mbledhjen dhe kompletimin e të dhënave sipas pyetësorëve të hartuar nga ARKEP, atëherë si rezultat i kësaj është parë e nevojshme që të shtyhet afati i analizës së këtyre tregjeve edhe për 3 muaj, respektivisht deri më datë 15 Janar 2018.

Atëherë është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike;

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 24/ 10/ 2017

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Kreshnik Gashi

Kryetar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet;

- Ndërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike,
- Autoritetit Kosovar të Konkurrencës,
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike, ARKEP
- Departamentit Ligjor, ARKEP; dhe
- Arkivit